



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 7 shtator 2015, në mbledhjen XVI – të (gjashtëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama,, z. Shaban Osmani, z. Radisav Perović.z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Antigona Dibrani, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Aleksandra Jovanoviq, Bekim Karaxhija dhe Skender Shatri, OSBE, z. Nylias Gergo, LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 gusht 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Vlerësimi i përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor dhe caktimi i bartësve për përgatitjen e të dhënave statistikore për fëmijët e komuniteteve RAE të cilët vijnë në mesimet në shkollimin fillor dhe të mesëm dhe fëmijëve të cilët eventalisht e kanë braktisur shkollimin në nivelet e cekura.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, sipas informacioneve që i kemi viti i ri shkollor për nxënësit e komuniteteve RAE ka filluar pa probleme dhe vlen të

përmendet se nuk është shënuar asnjë rast që ndonjë nxënës e ka braktisur shkollimin.

z. Xhafer Ademi, theksoi, viti i ri shkollor ka filluar mbarë për të gjithë nxënësit duke përfshirë edhe nxënësit e komuniteteve RAE, ngecje mund të themi se ka pas për regjistrimin e nxënësve në kl. I^{rë} ngase prindërit kanë neglizhuar me i regjistruar në kohën e duhur përkatësisht në muajt maj dhe qershor, mirëpo edhe kjo çështje është zgjidhur. Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës dhe psikologun nxënësit e klasave të para nuk janë sistemuar në një klasë por i kemi shpërndarë në paralelet ekzistuese.

Problem ka paraqitur edhe riatdhesimi i nxënësve të cilët më parë kanë emigruar mirëpo me angazhim të ndërsjellë komunitet – shkollë ata janë regjistruar me përjashtim të katër nxënësve të cilët për momentin nuk janë regjistruar ngase jemi në pritje të vërtetimeve përkatëse nga shkollat ku ata kanë vijuar mësimet.

Sa i përket regjistrimit në shkollimin e mesëm mund të them se të gjithë të interesuarit të përkatësisë së komuniteteve RAE, pa kritere, janë regjistruar në shkollë të mesme.

Në fund dëshiroj t'ju informoj se konkursi për bursa është publikuar dhe të interesuarit mund të aplikojnë deri më datën 19 të këtij muaji kur edhe mbyllet konkursi.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, ashtu si edhe shumë vite më parë edhe këtë vit i kemi siguruar tekstet shkollore për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të komuniteteve RAE, por edhe për disa nxënës të komunitetit shumicë të cilët e kanë gjendjen e rëndë ekonomike. Sipas informacioneve që i kam asnjë komunë në Kosovë nuk i siguron tekstet shkollore për nxënësit e komuniteteve pakicë të cilët vijojnë shkollën e mesme, andaj unë i përgëzoj institucionet e Komunës së Podujevës për ofrimin e kësaj ndihme dhe e falënderoj Kryetarin e Komunës, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe gjithë të tjerët të cilët kontribuojnë në këtë drejtim.

z. Shaban Osmani, theksoi, të gjithëve na gëzon fakti se viti i ri shkollor ka filluar për së mbari duke përfshirë edhe nxënësit e komuniteteve RAE, në veçanti duhet përhëndetur veprimin që nxënësit e komuniteteve RAE të regjistruar në kl. I^{rë} nuk janë grumbulluar në një paralele por janë shpërndarë në paralelet ekzistuese ngase kjo mënyrë ndikon drejtpërdrejt në integrimin e plotë të tyre.

Konsideroj se do të ishte mirë që për mbledhjen e ardhshme të përgatitet lista e të gjithë nxënësve të komuniteteve RAE me të dhënat në cilat shkolla dhe cilat klasë vijojnë mësimet.

z. Xhafer Ademi, theksoi, deri tash asnjëherë nuk kemi pasë rast që në një paralele të klasës së I^{rë} të ketë më shumë se 4-5 nxënës të komuniteteve RAE ngase gjithëherë janë shpërndarë në më shumë paralele.

z. Shaban Osmani, theksoi, vlen të përhëndetet fakti se sikur vitet e mëparshme edhe këtë vit nxënësit e komuniteteve RAE janë regjistruar pa kritere në Shkollë të Mesme të Lartë, pra nuk ka mbetur asnjë nxënës i interesuar pa u regjistruar në shkollë të mesme, derisa jemi në dijeni se nxënësit e komunitetit shqiptarë kanë probleme për regjistrim në shkolla të mesme. Gjithashtu nxënësit e cekur vitin e kaluar kanë shfrytëzuar bursat.

z. Xhafer Ademi, theksoi, e falënderoj z. Liman Zeqirin, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, për ndihmën që na e ka dhënë vitin e kaluar për përgatitjen e dokumentacionit për bursa, ngase afati ka qenë shumë i shkurtë mirëpo përkundër kësaj ne kemi arritur që të interesuarit t'i pajisim me dokumentacionin e nevojshëm dhe të gjithë nxënësit kanë qenë përfitues të bursës.

z. Liman Zeqirin, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, konsideroj se obligim i veçantë është arsimimi dhe shkollimi i fëmijëve ngase kjo është ardhmëria e jonë.

Më kujtohet që kohë më parë në Shkolla të Mesme të Larta nuk ka qenë asnjë nxënës i komuniteteve RAE, mirëpo në bazë të aktiviteteve dhe angazhimeve fatbardhësisht kjo çështje ka ndryshuar në të mirë.

U përmend se duke ju falënderuar Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorëve të shkollave është dera e hapur për të gjithë nxënësit e komuniteteve RAE të cilët dëshirojnë të regjistrohen në Shkollë të Mesme të Lartë, pra për këtë kategori nuk ka kriterë, për këtë jam angazhuar deri tash e do të angazhohem edhe në të ardhmen.

Sa i përket konkursit të publikuar për bursa, me përgjegjësinë më të madhe them se në bashkëpunim me Xhafer Ademin, brenda një dite do t'i rregullojmë shkresat dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Për raporte ndëretnike lirshëm mund të them se ne bashkëjetojmë me komunitetet përkatëse dhe nuk kemi asnjë problem e këtë e kemi theksuar edhe në nivele më të larta se Komuna e Podujevës është shembull i bashkëjetesës me të gjitha komunitetet.

z. Bekim Karagjija, theksoi, gjatë debatit u përmend çështja e nxënësve të komuniteteve RAE që janë regjistruar në kl. I – ^{re} të cilët janë shpërndarë në paralele të shumta, kjo për mua është shumë e qëlluar ngase është mënyra më e mirë dhe më efikase që kategoria e cekur të integrohet me bashkëmoshatarët e tyre, përndryshe në këtë çështje e kemi monitoruar dhe kemi konstatuar se integrimi në përgjithësi është maksimal.

Sa i përket vetëdijesimit të prindërve për shkollim të fëmijëve, ne kemi komunikuar disa herë me qytetarë të komuniteteve RAE dhe po ashtu jemi në dijeni se edhe Institucionet komunale disa herë kanë ndërmarrë iniciativa dhe takime për vetëdijesimin e prindërve për shkollimin e fëmijëve, mirëpo konsideroj se do të ishte mirë që prindërit të informohen edhe për ndëshkimet në rast se fëmijët nuk i dërgojnë në shkollimin fillor që është i obligueshëm.

z. Xhafer Ademi, theksoi, vitin e kaluar shkollor kanë qenë të angazhuar dy profesorë, me pagesë nga OJQ “ Vois of Roma “, të cilët i kanë monitoruar nxënësit e komuniteteve RAE dhe sipas nevojës kanë qenë të gatshëm të mbajnë edhe mësim shtesë.

z. Bahri Selimi, theksoi, pajtohem se do të ishte mirë që të kemi listën nxënësve të komuniteteve RAE të cilët vijojnë mësimet por konsideroj se edhe më e rëndësishme do të ishte që të kemi listën e fëmijëve të cilët për nga mosha do duhej të ishin në shkollë por për arsye të ndryshme nuk i vijojnë mësimet, këtë po e lidhi me atë që u tha gjatë debatit se disa prindër për shkak të neglizhencës nuk i kanë regjistruar me kohë fëmijët në kl. I – ^{re}, pra në këtë aspekt është i nevojshëm

vetëdijesimi i atyre prindërve por edhe informimi për masat ndëshkuese në rast se nuk i dërgojnë fëmijët në shkollim fillor.

z. Antigona Dibrani, përfaqësuese e Stacionit të policisë në Podujevë, theksoi, duke u bazuar në përgjegjësinë time dëshiroj t'ju flas për aspektin e sigurisë sa i përket fillimit të vitit të ri shkollor, në këtë drejtim ashtu si vitet e mëparshme edhe këtë vit që nga 1 shtatori kemi funksionuar në implementimin e Planit operativ, plan i cili quhet: Siguria në rrugë dhe shkolla, çështje për të cilën zyrtarët e policisë në terren janë të angazhuar në rroba civile por edhe në uniformë policore.

Shkollat në Komunën e Podujevës edhe gjatë viteve të kaluara, po flas për një periudhë më të gjatë kohore, kanë qenë ndër shkollat më të qeta në Republikën e Kosovës, sa i përket incidenteve, kjo është arritur fal angazhimit të të gjitha strukturave relevante por edhe të qytetarëve në përgjithësi.

Këtë vit sfidë për ne do të jetë vetëdijesimi i kundërvajtësve me thektë veçantë shitësve ambulantë afër shkollave e në veçanti atyre pran shkollave fillore, për këtë ne në bashkëpunim me inspektorët kompetent kemi filluar aksionin prej 1 shtatori në mënyrë që të lirohen trotuaret dhe nxënësit të qarkullojnë lirshëm.

Dy të shtunat paraprake është mbajtur testi kombëtar i maturës, pra në dy pjesë dhe ka kaluar pa incidente.

Gjithashtu prej 1 shtatori kemi filluar implementimin e një projekti që ka të bëjë me identifikimin e problemeve apo pengesave në afërsi të shkollave e që në mes tjerash përfshihet identifikimi i mungesës së shenjave sinjalizuese të trafikut, të rrethojave të oborreve të shkollave, trotuareve etj. Në këtë kontekst organeve kompetente disa herë i jemi drejtuar në formë të shkruar për rrezikshmërinë për nxënës dhe kalimtarë të tjerë që paraqet mungesa e kapakëve të pusetave që pikërisht janë në afërsi të shkollave.

Jemi në dijeni se mësimi ka filluar pa probleme në të gjitha shkollat, përveç shkollës në fshatin Halabak, ku është djegur objekti shkollor dhe për këtë natyrisht janë duke u bërë hetimet.

Përndryshe situata e sigurisë në përgjithësi është e mirë dhe në krahasim me periudhën e vitit paraprak ka rënie të veprave penale.

Me vëmendje i dëgjova diskutimet e juaja, në veçanti për çështjen e regjistrimit të fëmijëve në kl. I –^{rë}, mirëpo nuk dëgjova se a ka ndonjë fëmijë me nevoja të veçanta që ka nevojë për transport për vijimin e mësimëve në shkollë të veçantë në fshatin Gllamnik.

z. Xhafer Ademi, theksoi, prej komuniteteve RAE është një nxënës me nevoja të veçanta i cili ka vijuar mësimet në shkollën përkatëse në fshatin Gllamnik, mirëpo tash është aftësuar dhe mësimet i vijon në shkollë të rregullt në Podujevë, mirëpo ky nxënës është nën monitorim për vlerësimin e aftësive të tij përkatësisht për atë se a ka nevojë që të kthehet sërish në shkollën e veçantë në Gllamnik.

Gjithashtu është një nxënës me nevoja të veçanta i cili nuk i vijon mësimet, për këtë rast unë e kam siguruar transportin për bartje deri te njëra prej dy qendrave tona ku i mbajmë mësimet shtesë në mënyrë që fillimisht të adaptohet, mirëpo edhe përkundër angazhimit mjaftë të madh të z. Behije Gashit, nga Qendra për Punë Sociale, nuk kemi mundur të gjejmë gjuhë të përbashkët me prindërit e atij fëmiju.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, në mbledhje për herë të parë janë të pranishëm edhe pjesëtarët e kontingjentit të ri Hungarez të KFOR – LMT, kërkoj falje ngase është dashtë në fillim t'ju njoftoj për këtë, mirëpo tani shfrytëzoj rastin dhe i përshëndes dhe jam i mendimit se bashkëpunimi do të jetë i mirëfilltë sikur deri më tash.

z. Nyljas Gergo, LMT, fillimisht u falënderua për përshëndetjen dhe shtoi, jam i bindur se do të vazhdoj punën e mirë ashtu siç e kanë bërë paraardhësit e mi.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.40'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006- 83340
Podujevë,
7 shtator 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**